

**VENDIM**  
**Nr. 647, datë 30.7.2020**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2020, MIRATUAR PËR**  
**MINISTRINË E KULTURËS, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE KAPITALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e saj të miratuar për vitin 2020, i shtohet fondi prej 149 000 000 (njëqind e dyzet e nëntë milionë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve kapitale.

2. Shtesa e fondit prej 149 000 000 (njëqind e dyzet e nëntë milionë) lekësh ndahet, si më poshtë vijon:

- a) Në programin buxhetor 08220 “Trashëgimia kulturore dhe muzetë”:
  - i. në zërin “Shpenzime kapitale”, llogaria 230, fondi prej 8 200 000 (tetë milionë e dyqind mijë) lekësh;
  - ii. në zërin “Shpenzime kapitale”, llogaria 231, fondi prej 109 800 000 (njëqind e nëntë milionë e tetëqind mijë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 08230 “Art & kultura”, në zërin “Shpenzime kapitale”, llogaria 231, fondi prej 31 000 000 (tridhjetë e një milionë) lekësh.

3. Efekti financiar përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2020.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**